



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Bilisht, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ngritja e Qendrës Rinore të Devollit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: “Punime
ndertimi -45210000-2**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 18,705,058.79 (tetëmbëdhjetë milion e shtateqind e pesë mijë e
pesëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e nëntë) leke pa tvsh financuar nga **Buxheti i Shtetit dhe
Buxheti i Bashkisë Devoll”**.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim”
Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit
Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbështetje te Nenit 26 ”Formulari
përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për
Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet
ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga
autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës te vetdeklarimit, sipas
parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit
publik”*.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore per 3 vitet 2021,2022,2023 ,ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar **duhet te jete jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates objekt prokurimi.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43 pika 2 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”,* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”* siç është rasti i kësaj procedure

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondit limit I përlllogaritur dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të

dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2. Per te vertetuar nje aktivitet te qendrueshem Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

****Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.***

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendor.

Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së perlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a.Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës , shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;

- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti.
- ✓ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese dokumentacionin e sipërcituar për secilin rast respektivisht.
 - ✓ Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Ne rastin e Bashkimit te operatoreve ekonomike, Operoret duhet ti permbahen percaktimeve te nenit 88 te VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Argumentimi: AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku

percaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Në rastet e Nënkontraktimit, kërkohet që vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkepunimit për marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga AK. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesmarrjes sëoperatoreve ekonomik në tender.

Të dyja këto kërkesa I vendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi për vlerësim, të gjithëoperatoreve ekonomik ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marrëveshjet përkatëse të nënkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P - 2 A** Ndërtime civile dhe industriale;
- **N.P - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S – 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S – 2 A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- **N.S – 8 A** Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
- **N.S – 14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e liçencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përlllogaritur të kontratës.

NP - 1 A Punime gërmimi në tokë

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori liçence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

- **2.5** “Gërmim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m”
- **2.25a** “Gërmim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me goma 0.25m3, shkarkimi ne toke”
- **2.37/5b** Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km

N.P- 2 A Ndërtime civile dhe industrial;

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Kjo kategori liçence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- **2.130.** Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20
- **2.585** Plinta b/a C25/30
- **2.573** Soleta b/a C 20/25
- **3.207/1** Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri
- **2.262/3** Shtrese betoni C 12/15
- **2.166 F V** hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm
- **2.166/1a** F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm
- **2.76** Mur tulle me vrima, t=20cm
- **2.108/1c** Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires
- **2.375/1** F V dritare d/alumini plastike me dopio xham
- **2.373/1** F V vetrare d/alumini plastike me dopio xham

- 2.383/1 F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re.
- 2.268/a Shkalle mermer montazhi
- 2.267/a Shtrese me pllaka grez porcelanato
- 2.290 Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura
- 2.288 Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit
- 2.414 F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar
- 2.256/b Mbulim çatie me panele sanduich

N.P – 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- 2.358/b Veshje fasade me polisterol $t=5\text{cm}$ + rrjete + suva.
- 2.300 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah
- 2.310 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
- 2.328/1 Patinim muri me stuko
- 2.330/1 Patinim tavani me stuko
- 2.297/a Veshje tavani me kartonxhes
- 2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte
- 2.212 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm
- 2.209 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100
- 2.206 Kasete shkarkimi me llamarine xingat
- 2.203 Veshje korrnize llamarine xingat
- 2.196 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Për punimet speciale të ndërtimit :

N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- 2.281 Heqje pllaka dyshemeje
- 2.281/1 Heqje bazamake shkallësh
- 2.370/1 Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese
- 2.396 Heqje vetrate duralumini ekzistuese
- 2.405/1 Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh
- 2.426/3 Prishje shtresa betoni
- 2.426 Prishje mur tulle pa pastrim
- 2.426/4 Prishje soleta b/a
- 2.615 Heqje pajisje hidrosanitare

N.S - 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- **3.406 F V tub drenazhi Ø 150 mm**
- **2.501 F.V WC alla frenga**
- **2.495 F.V lavaman porcelain**
- **2.491/b F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16**
- **2.494/2 F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm**
- **2.515 F.V pilete dysHEMEJE Ø 50**
- **2.512/2 F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+4)**
- **2.520 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110**
- **2.341 Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize**

N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- **2.181 F V konstruksione metalike te perbera**
- **4.2 F.V Kapriata metalike me profile**
- **3.721 F.V. Llamarine xingat e valezuar**

N.S - 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv:

- **2.480/3 F.V tub plastmasi Ø 22-26mm**
- **2.481/2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm²**
- **2.481/3 F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm²**
- **2.481/5 F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm²**
- **2.483 F.V Çelesa e priza 10 A**
- **2.487/b F.V kuti suport pllaket 4 mod**
- **2.485/b F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T**

- 2.490/1a F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A
- 2.490/2 F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A
- 2.490/1e F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A
- 2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m
- 2.500 F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur
- 2.535 F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A
- 2.548 F. V. Kontator trefazor,380V,40A
- 2.487 F.V Kutiderivacioni plastm
- 2.485/d F.V priza shuko universal

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A	Punime gërmimi në tokë	2.5 2.25a 2.37/5b	0- 20 milion lekë	45,841.60 Lek
N.P- 2 A	Ndërtime civile dhe industrial	2.130. 2.585 2.573 3.207/1 2.262/3 2.166 2.166/1a 2.76 2.108/1c 2.375/1 2.373/1 2.383/1 2.268/a 2.267/a 2.290 2.288 2.414 2.256/b	0- 20 milion lekë	9,143,416.06 leke
N.P- 3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	2.358/b 2.300 2.310 2.328/1 2.330/1 2.297/a	0- 20 milion lekë	5,180,061.75 leke

		2.404/1 2.212 2.209 2.206 2.203 2.196		
N.S – 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	2.281 2.281/1 2.370/1 2.396 2.405/1 2.426/3 2.426 2.426/4 2.615	0- 20 milion lekë	513,468.40 leke
N.S – 2 A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	3.406 2.501 2.495 2.491/b 2.494/2 2.515 2.512/2 2.520 2.341	0- 20 milion lekë	659,318.58 leke
N.S – 8 A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.	2.181 4.2 3.721	21- 50 milion lekë	1,087,669.74 leke
N.S – 14 A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	2.480/3 2.481/2 2.481/3 2.481/5 2.483 2.487/b 2.485/b 2.490/1a 2.490/2 2.490/1e 2.496 2.500 2.535 2.548	21- 50 milion lekë	627,459.20 leke

		2.487 2.485/d		
--	--	------------------	--	--

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te paktën:

a. 1(nje)inxhinier ndertimi

Inxhinieri i mësipërm duhet të jete i siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierit të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie*” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Inxhinier Ndërtimi

1 (një)

Ne preventiv jane parashikuar punime per te cilat eshte e nevojshme kerkesa e vendosur nga Ak per nje Inxhinieri i ndertimit i cili duhet te organizoje punen ne zbatim, dhe kryerjen e punimeve si dhe zbatimimi i sipas projektit te zbatimit.

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - 2.130. Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20 - 2.585 Plinta b/a C25/30 - 2.573 Soleta b/a C 20/25 - 2.262/3 Shtrese betoni C 12/15 - 2.166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - 2.166/1a F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm - 2.181 F V konstruksione metalike te perbera - 4.2 F.V Kapriata metalike me profile - 3.721 F.V. Llamarine xingat e valezuar |
|--|

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje **Drejtimesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndertimi dhe të deklaroje se ai është i

disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kriteri për drejtuesin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ai është përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet te jetë **27(njezet e shtate)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme , shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të permbushur kontratën.

Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat

themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 27 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendim nr.216 DT 13.04.2023 „Sistemi I Integruar I Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim“ Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës e cila **ka nje afat prej 12 muajsh**.

Konkretisht sipas analizes teknike rezulton se nevojiten: Teknik Ndërtimi 1 (nje), Saldatore 2 (Dy); Hekurkthyes 2 (dy), Karpentier 2 (dy), Elektracist 1 (Nje), Hidraulik 1 (Nje), Pllakaxhi 2 (Dy), Suvaxhi 2 (Dy), Murator 1 (Nje), Usta muresh gipsi 1 (Nje), Eskavatorist 1(nje), Shofere Kamioni 1 (Nje), Shofer autovinci 1 (Nje), Manovrator ruli dhe grejderi 1 (Nje), Punetore te tjere 7 (Shtate), + 1 (nje) inxhiner= 27 punonjes total

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në **listëpagesa për të paktën muajin e fundit**, të paisur me kontrate pune (të vlefshme), diplome/deshmi të lëshuar nga Autoritetet përgjegjëse/ shtetërore/organe/ institute të akredituar në Republikën e Shqipërisë, që vërtetojnë kualifikimin profesional, ku nga këta të jenë të paktën:

- Teknik Ndërtimi	1 (Nje)
- Saldatore	2 (Dy)
- Hekurkthyes	2 (Dy)
- Karpentier	2 (Dy)
- Elektracist	1 (Nje)
- Hidraulik	1 (Nje)
- Murator	1 (Nje)
- Usta muresh gipsi	1 (Nje)
- Pllakaxhi	2 (Dy)
- Suvaxhi	2 (Dy)

- | | |
|--------------------------------|---------|
| - Eskavatorist | 1 (Nje) |
| - Shofere Kamioni | 1 (Nje) |
| - Shofer Auto vinci | 1 (Nje) |
| - Manovrator ruli dhe grejderi | 1 (Nje) |

Manovratori duhet të jete punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist, rul, grejder) dhe (shofer kamioni, auto vinci) për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor.

- ✓ Manovratori mund te jete i kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit. ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne si dhe mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kerkesa per deshmitë e manovratoreve bazohet ne Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi I përdorimit të makinerive të ndërtimit”

Specialistet e mesiperme jane vendosur ne perputhje me llojin e kontrates, zerat e punimeve dhe objektin qe ndertohet me nje numer te mjaftueshem per realizimin me sukses te punimeve.

1.Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Per te ndjekur punimet ne teren dhe per te organizuar dhe kontrolluar punetoret.

2 (Dy) Saldatore sepse ne preventive jane parashikuar punime per furnizim vendosje struktura metalike dhe kapriata.Keto punime se bashku me zera te tjere te parashikuar ne preventiv

2.181	F V konstruksione metalike te perbera	ton	2.87
4.2	F.V Kapriata metalike me profile	ton	2
3.721	F.V. Lllamarine xingat e valezuar	kg	300
2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	90
2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	72
2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	copë	8
2.203	Veshje korrnize llamarine xingat	m2	50
2.256/b	Mbulim çatie me panele sandwich	m2	330
2.414	F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar	ton	3

2 (Dy) Hekurkthyes sepse ne preventive jane parashikuar punime per furnizim vendosje hekuri per plinta dhe soleta.Keto punime se bashku me zera te tjere te parashikuar ne preventiv

2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.38 7
2.166/1 a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	0.09 8

2 (Dy) karpentiere: Ak e ka gjykuar te arsyeshme angazhimin e 2 karpentiereve gjate zbatimit te punimeve duke ju referuar punimeve te parashikuara ne preventiv dhe ne projektin e zbatimit. Jane parashikuar sasi te konsiderueshme punimesh per ndertim struktura prej betoni etj.

2.130.	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20	m3	4
2.585	Plinta b/a C25/30	m3	3.1
2.573	Soleta b/a C 20/25	m3	4.2
2.262 /3	Shtrese betoni C 12/15	m3	13

1 (Nje) Elektracist sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar realizimi i instalimeve elektrike per fuqine dhe ndricimin:

2.480/3	F.V tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	500
---------	-----------------------------	----	-----

2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm ²	ml	100 0
2.481/3	F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm ²	ml	200
2.481/5	F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm ²	ml	100
2.483	F.V Çelesa e priza 10 A	copë	50
2.487/b	F.V kuti suport pllaket 4 mod	copë	30
2.485/b	F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T	copë	50
2.490/1 a	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	copë	10
2.490/2	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A	copë	10
2.490/1 e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	copë	2
2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	copë	4
2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm ² , i zhveshur	ml	50
2.535	F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A	copë	2
2.548	F. V. Kontator trefazor,380V,40A	copë	1
2.487	F.V Kutiderivacioni plastm	copë	10
2.485/d	F.V priza shuko universal	copë	30

1 (Nje) Hidraulik sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar realizimi i instalimeve hidraulike per nyjet sanitare dhe te drenazhit.

2.501	F.V WC allafrenga	copë	8
2.495	F.V lavaman porcelani	copë	4
2.491/ b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16	ml	200
2.494/ 2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	copë	20
2.515	F.V pilete dysHEMEJE Ø 50	copë	10
2.512/ 2	F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+4)	copë	4
2.520	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110	ml	100

1 (Nje) Murator sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar realizimi i muraturave te tulles

2.76	Mur tulle me vrima, t=20cm	m ³	6
------	----------------------------	----------------	---

1 (Nje) Usta muresh gipsi sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar realizimi i mureve ndares prej gipsi dhe i tavaneve te varura prej gipsi

2.108/1c	Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires	m2	80
2.328/1	Patinim muri me stuko	m2	750
2.330/1	Patinim tavani me stuko	m2	700
2.297/a	Veshje tavani me kartonxhes	m2	56
2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	150 0

2 (Dy) Pllakaxhinj sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar shtrimi i dyshemese me pllaka, veshja e tualeteve me pllaka, veshja e shkalleve me pllaka, shtrimi i oborrit me pllaka dhe vendosja e bordurave

2.268/a	Shkalle mermer montazhi	m2	30
2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	780
2.290	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	ml	50
2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2	250
2.267/ 1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	80

2 (Dy) Suvaxhinj sepse ne projekt dhe preventive jane parashikuar punime te suvatimit te mureve te jashtem dhe te brendshem si dhe veshja e fasades me termoizolim dhe grafiato

2.358/ b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	m2	540
2.300	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m2	50
2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	50

- **Manovratoret dhe Shoferet**

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendim nr.216 DT 13.04.2023 „Sistemi I Itegruar I Manualit Te Cmimeve Ne Ndetim „Konkretisht numri I drejtuesve eshte ne perputhje numrin dhe llojin e makinerive qe perkojne me oret e punes sipas zerave te analizes teknike dhe grafikun e punimeve eshte vendosur edhe numri i manovratoreve dhe shofereve . Persa i perket numrit te shoferave, analiza e e zerave sipas manualit nuk na dikton kohen qe duhet per te transportuar materialet e ndertimit, mbetjet inerte etj

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr.	Mjete	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 5 ton me vinc	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Ekskavator me goma ose me zinxhire	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Paisje per matje topografike	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Betoniere kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Rul kompresor me vibrim	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Elektrosaldatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator siperfaqesor	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Gazogjen	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Elektroorgano	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Trapano elektrik	2 copë	Në pronësi ose me qera
15	Pompe suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Torno	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Tranzhe elektrike	1 copë	Në pronësi ose me qera

Pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kerkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier", si më poshtë vijon:

2

Nr.	Pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	27 copë	Në pronësi ose me qera
2	Jelekë me shirita fosforishentë	27 copë	Në pronësi ose me qera
3	Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5 kg	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Tabela Sigurimi Teknik	10 copë	Në pronësi ose me qera
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme)

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes., cdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit.

Dokumentacioni shoqëruet i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Konkretisht:

- **Mjet transporti vetshkarkues ≥ 7 ton** nevojitet per transportin e dherave te dala nga germimet, materialeve te prishjes si dhe transportin e cakullit.
- **Mjeti i transportit deri ne 5 ton me vinc** nevojitet per transportin e materialeve te ndertimi si cimento ,hekur, etj.
- **Betoniere** nevojitet për përgatitje e llaçeve dhe betoneve zëri në preventiv: 2.130. Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20; 2.585 Plinta b/a C25/30; 2.573 Soleta b/a C 20/25; 2.262/3 Shtrese betoni C 12/15; 2.300 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah; 2.310 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
- **Moto gjeneratori** nevojitet për venien ne pune te betonieres per përgatitje e llaçeve dhe betoneve zëri në preventiv: 2.130.Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20; 2.585 Plinta b/a C25/30; 2.573; Soleta b/a C 20/25; 2.262/3 Shtrese betoni C 12/15; 2.300 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah; 2.310Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
- **Eskavatori me goma ose zinxhir** nevojitet per germim dheu sipas zerave ne preventiv
- **Paisje per matje topografike** per kryerjen e rilevimit sipas kuotave te percaktuara ne projekt.
- **Grejder** eshte e nevojshme per realizimin e punimeve te shtresave te cakullit dhe stabilizantit sipas parashikimeve te projektit teknik dhe preventivit.

- **Ruli kompresor me vibrim** është e nevojshme për realizimin e punimeve të shtresave të çakullit dhe stabilizantit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Elektrosaldatricja** është e nevojshme për realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike të nderkatit dhe catise sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Vibratori** është e nevojshme për realizimin e punimeve të betonit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Vibratori sipërfaqësor** është e nevojshme për realizimin e punimeve të soletës së betonit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Gazogjeni** është e nevojshme për realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Elektroorgano** është e nevojshme për realizimin e punimeve të shtresave të izolimit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Trapano elektrik** është e nevojshme për realizimin e punimeve të cmontimit dhe montimit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Pompe suvatimi** është e nevojshme për realizimin e punimeve të suvatimit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Torno** është e nevojshme për realizimin e punimeve të prodhimit të detaleve speciale për montimin e strukturave metalike dhe ashensorit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.
- **Tranzhe elektrike** është e nevojshme për realizimin e punimeve të prodhimit të elementeve speciale për montimin e strukturave metalike dhe ashensorit sipas parashikimeve të projektit teknik dhe preventivit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT: